

# SKEMA E CERTIFIKIMIT PËR PERSONAT QË PUNOJNË NË IMPIANTET, INSTALIMET, LINJAT DHE PAJISJET ELEKTRIKE

## KUSHTET PARAPRAKE

Aplikantëve; kandidatëve dhe mbajtësve të certifikatave u kërkohet familjarizimi me rregulloret teknike përkatëse, teknologjitë, standardet dhe praktikën e shfrytëzimit/përdorimit/instalimit/mirëmbajtjes të pajisjes/instalimeve dhe linjave elektrike.

**KUSHTET PARAPRAKE PËR APLIKIM NË KATEGORIN “A” – Personat që punojnë me impiantet, instalimet dhe pajisje elektrike, apo pranë tyre, sigurimi teknik elektrik.**

### **GRUPI I I-RË I SIGURIMIT TEKNIK ELEKTRIK.**

Grupi I i sigurimit teknik elektrik u përket punëtorëve të thjeshtë, punëtorëve në ndërtim, bojaxhi, punonjës në provë për elektricista, praktikantëve si edhe të gjithë personelit të repartëve të centralit që nuk provohen për njohjen e rregullores së sigurimit teknik si psh: pastruesve të impianteve elektrike, mekanikëve dhe shoferëve që punojnë me vinça në ndërmarrjet elektrike, saldatorë, elektrovinçier etj.

**Aplikantëve për Grupin e I-rë të sigurimit teknik u kërkohet:**

1. **Mosha** - Jo më pak se 18 vjeç.
2. **Edukimi minimal / Kualifikime / Trajnime:** - Të ketë mbaruar ciklin e arsimit të detyruar 8/9 vjeçar.
3. **Eksperiencia në punë** - Koha e punës nuk përcaktohet. Instruktohen kur futen për herë të parë në punë dhe më vonë çdo vit.
4. **Aftësitë fizike:** Të jetë i aftë fizikisht dhe mendërisht për punë, veçanërisht lidhur me të parët, të dëgjuarit, aftësisë lëvizëse, etj. Vërtetim mjekësor i lëshuar jo më vonë se 6 muajt e fundit.

### **GRUPI I II-TË I SIGURIMIT TEKNIK ELEKTRIK.**

Grupi II i sigurimit teknik elektrik u përket elektricistëve me kualifikim të ulët, praktikantëve të shkollave profesionale të mesme elektrike dhe inxhinierisë, kontrollorëve të linjave, bojaxhinjve të shtyllave elektrike, saldatorëve, elektro-vinçierëve, elektropompistëve, elektrokompresoristëve, telefonistëve etj.

**Aplikantëve dhe mbajtësve të certifikatave të Grupi II-të i kërkohet:**

1. **Mosha** - Jo më pak se 18 vjeç.
2. **Edukimi minimal / Kualifikime / Trajnime (të plotësoje të paktën njërin nga kushtet e mëposhtme):**
  - të ketë mbaruar ciklin e arsimit të detyruar 8/9 vjeçar.
  - të ketë kryer edukim profesional teknik (elektrik), ose një trajnim të paktën 8 ore në lidhje me ndihmën e pare dhe njohuritë mbi rrezikun që vjen nga rryma elektrike.
  - Të jetë certifikuar me grupin e parë të sigurimit teknik,
3. **Eksperiencia në punë:** - Jo më pak se një vit në punë në profilin përkatës. Koha e punës për praktikantët nuk normohet. Fotokopje e i librezës së punës/vërtetim nga punëdhënësi.
4. **Aftësitë fizike:** Të jetë i aftë fizikisht dhe mendërisht për punë, veçanërisht lidhur me të parët, të dëgjuarit, aftësisë lëvizëse, etj. Vërtetim mjekësor i lëshuar jo më vonë se 6 muajt e fundit.

### **GRUPI I III-TË I SIGURIMIT TEKNIK ELEKTRIK.**

Grupi III-të, i sigurimit teknik elektrik u përket personelit elektroteknik elektromontjer dhe elektromekanik i të gjithë specialistëve përgjegjës, specialistëve përgjegjës të ndërtesës në central, nënstation, impiante shpërndarëse dhe në rrjetin elektrik, telefonistëve në subjektet elektrike dhe personelit elektrik teknik drejtues në telekom.

**Aplikantëve dhe mbajtësve të certifikatave të Grupi III-të i kërkohet:**

1. **Mosha** - Jo më pak se 18 vjeç.
2. **Edukimi minimal / Kualifikime / Trajnime (të plotësoje të paktën njërin nga kushtet e mëposhtme):**
  - Të ketë mbaruar shkollën 8/9 vjeçare (Arsimin e Detyruar), duke e dëshmuar me një dokument të lëshuar nga autoritetet përkatëse. (diplomë, dëftesë, vërtetim etj.) dhe kurs kualifikimi të plote në profesion ose shkallen e ulët profesionale për specialitetin dhe të jetë i certifikuar të paktën 6 muajt me pare sipas grupit të II të sigurimit teknik.
  - Të ketë mbaruar shkollën e mesme profesionale të specialitetit dhe të ketë jo më pak se 3 muajt eksperience pune.

- Të ketë mbaruar ciklin bachelor ose master për inxhinieri jo elektrike dhe të ketë jo me pak se 3 vite eksperience pune në fushën e kërkuar.
3. **Eksperienca në punë (të plotësoje të paktën njërin nga kushtet e mëposhtme):**
- Jo më pak se 6 muaj punë në grupin e II-të, të sigurimit teknik, për personat që kanë mbaruar shkollën 8/9 vjeçare dhe kanë përfunduar një kurs kualifikimi të plotë në profesion ose shkollën e ulët profesionale për specialitetin elektroteknik.
  - Jo më pak se 3 muaj punë në grupin e II-të të Sigurimit teknik, për personat që mbarojnë shkollën e mesme profesionale të specialitetit elektroteknik.
  - Jo me pak se 1 muaj punë, në grupin e II-të, të Sigurimit teknik, për inxhinierët e rinj. Të ketë mbaruar ciklin bachelor, ose master për inxhinieri elektrike dhe të ketë jo me pak se 1 muaj eksperience pune.
4. **Aftësitë fizike:** Të jetë i aftë fizikisht dhe mendërisht për punë, veçanërisht lidhur me të parët, të dëgjuarit, aftësisë lëvizëse, etj. Vërtetim mjekësor i lëshuar jo me vonë se 6 muajt e fundit.

#### **GRUPI IV-TË, I SIGURIMIT TEKNIK ELEKTRIK**

Grupi i IV-të, i sigurimit teknik elektrik, u përket personelit elektroteknik, mjeshtrë elektromontues, personeli i ndërresës në central nënstacione dhe rrjete elektrike. Teknikëve dhe inxhinierëve të rinj.

**Aplikantëve dhe mbajtësve të certifikatave të Grupi IV-të i kërkohet:**

1. **Mosha** - Jo më pak se 22 vjeç.
2. **Edukimi minimal / Kualifikime / Trajnime (të plotësoje të paktën njërin nga kushtet e mëposhtme):**
  - Të ketë mbaruar shkollën e mesme profesionale të specialitetit dhe të ketë jo me pak se 3 muaj eksperience pune.
  - Të ketë mbaruar ciklin bachelor ose master për inxhinieri jo elektrike dhe të ketë jo me pak se 3 vite eksperience pune në fushën e kërkuar.
  - Të ketë mbaruar sistemin bachelor ose master për inxhinieri elektrike.
3. **Eksperienca në punë (të plotësoje të paktën njërin nga kushtet e mëposhtme)**
  - Të ketë eksperience punë prej të paktën 2 (dy) vitesh me certifikimin për Grupit III të sigurimit teknik (Libreza e punës, vërtetim/referencë nga punë dhënësi, kartoni i sigurimit teknik etj.), (që nënkupton se ka përbushur të gjitha kërkesat sipas kriterëve kualifikuese për grupin III).
  - Të ketë eksperience punë prej të paktën 1 (një) viti certifikimin për Grupin e III dhe të ketë mbaruar shkolle specialiteti, në fushën e kërkuar (Libreza e punës, vërtetim/referencë nga punë dhënësi, kartoni i sigurimit teknik etj.), (nënkuptohet se ka përbushur të gjitha kërkesat sipas kriterëve kualifikuese për grupin III)
  - Mbi 3 muaj eksperience punë në impiantet dhe linjat elektrike dhe të ketë mbaruar sistemin bachelor ose master për inxhinieri elektrike. (Libreza e punës, vërtetim/referencë nga punë dhënësi etj.)
  - Jo më pak se 2 vjet në grupin e III-të, të sigurimit teknik, ndërsa për personat që kanë mbaruar shkollë specialiteti jo më pak se 1 vit në grupin e III. Inxhinierët dhe tekniket e rinj duhet të kenë një stazh në punë në impiantet dhe linjat elektrike mbi tre muaj.
4. **Aftësitë fizike:** Të jetë i aftë fizikisht dhe mendërisht për punë, veçanërisht lidhur me të parët, të dëgjuarit, aftësisë lëvizëse, etj. Vërtetim mjekësor i lëshuar jo më vonë se 6 muajt e fundit.

#### **GRUPI V-TË, I SIGURIMIT TEKNIK ELEKTRIK.**

Grupi V-të, i sigurimit teknik elektrik u përket mjeshtrëve, teknikëve elektrikë dhe inxhinierëve.

**Aplikantëve dhe mbajtësve të certifikatave të Grupi V-të i kërkohet:**

1. **Mosha** - Jo më pak se 24 vjeç.
2. **Edukimi minimal / Kualifikime / Trajnime (të plotësoje të paktën njërin nga kushtet e mëposhtme):**
  - Të ketë mbaruar shkollën e mesme profesionale të specialitetit.
  - Të ketë mbaruar ciklin bachelor ose master për inxhinieri jo elektrike dhe të ketë jo me pak se 3 vite eksperience pune në fushën e kërkuar.
  - Të ketë mbaruar sistemin bachelor ose master për inxhinieri elektrike.
3. **Eksperienca në punë:**
  - Për mjeshtrat mbi 10 vjet në prodhim dhe mbi 3 vjet në grupin e IV të sigurimit teknik.
  - Për teknikët duhet të kenë 3 vjet punë në grupin e IV të sigurimit teknik.
  - Për inxhinierët të kenë stazh pune prej një viti në impiantet ose linjat elektrike.
4. **Aftësitë fizike:** Të jetë i aftë fizikisht dhe mendërisht për punë, veçanërisht lidhur me të parët, të dëgjuarit, aftësisë lëvizëse, etj. Vërtetim mjekësor i lëshuar jo me vonë se 6 muajt e fundit.

## KUSHTET PARAPRAKE PËR APLIKIM NË KATEGORIN “B” – Instalues dhe mirëmbajtës të pajisjeve, impianteve dhe instalimeve elektrike të tensionit të ulët.

### **ITU: Instaluesit dhe mirëmbajtësit të pajisjeve, impianteve dhe instalimeve elektrike të tensionit të ulët.**

Kategoria “B” ITU u përket mjeshtrëve, teknikëve elektrikë, instaluesve dhe mirëmbajtësve të pajisjeve, impianteve dhe instalimeve elektrike të tensionit të ulët.

**Aplikantëve dhe mbajtësve të certifikatave të kategorisë “B” ITU i kërkohet:**

1. **Mosha** - Jo më pak se 18 vjeç.
2. **Edukimi minimal / Kualifikime / Trajnime (të plotësoje të paktën njërin nga kushtet e mëposhtme):**
  - Diploma profesionale e shkollës së mesme,
  - Dëftese pjekurie e shkollës 8 - 9 vjeçare, të cilët kanë një eksperience pune 5 vjeçare, të dokumentuar nga punëdhënësi, të cilët kanë përfunduar një kualifikim profesional në këtë fushë.
3. **Eksperienca në punë në fushën specifike:**
  - Të diplomuarit me arsim të mesëm elektrikist, të paktën 1 vit përvojë pune në mirëmbajtjen e sistemeve elektrike, në rezidenca banimi, nën mbikëqyrjen e një specialisti me eksperiencë mbi 5 vjet punë në instalimin e sistemeve elektrike në shtëpi dhe rezidenca banimi.
  - Personel jo i diplomuar në arsim profesional, duhet të ketë të paktën 5 vjet përvojë pune në mirëmbajtjen e sistemeve elektrike, në rezidenca banimi, nën mbikëqyrjen e një specialisti me eksperiencë mbi 5 vjet punë në instalimin e sistemeve elektrike në shtëpi dhe rezidenca banimi.
4. **Aftësitë fizike:** Të jete i afte fizikisht dhe mendërisht për punë, veçanërisht lidhur me të parët, të dëgjuarit, aftësisë lëvizëse, etj. Aplikanti duhet të ketë në dokumentacionin për certifikim, fotokopje e vërtetimit mjekësor i lëshuar jo me vone se 6 muajt e fundit.

## KUSHTET PARAPRAKE PËR APLIKIM NË KATEGORIN “C” – Instaluesit e autorizuar për instalimin e linjave të tensionit të lartë

### **Instalues i Tipit 1 për linjat ajrore ose nëntokësore me tension të lartë të deri 30 kV (përfshirë).**

Kategoria C.1 - Instalues i Tipit 1 janë personat që bëjnë instalimin e linjave ajrore, ose nëntokësore me tension të lartë deri 30 kV (përfshirë).

**Aplikantëve dhe mbajtësve të certifikatave të kategorisë “C” Instalues i Tipit 1 i kërkohet:**

1. **Mosha:** të jetë një i rritur (mbi 18 vjeç), në kohën e parashtrimit të kërkesës;
2. **Edukimi minimal / Kualifikime / Trajnime:**
  - të kenë kualifikim si teknik i lartë në instalimet elektroteknike, ose arsim inxhinierik të nivelit Bachelor ose Master në këtë fushë.
  - të ketë kryer kurse individuale të njohura nga organi kompetent si ekuivalente me kualifikimet e lartpërmendura, si dhe ekuivalente të tjera të përcaktuara në zbatim të legjislacionit ose marrëveshjeve të tjera ndërkombëtare me vendet e treta, të njohura në Shqipëri;
  - të jetë i pajisur me dëshmi aftësie që dëshmon për punë, pa rrezik, në instalimet elektrike, të tensionit të lartë të lëshuar, nga një organizëm certifikues sipas grupit të III të Sigurimit Teknik.
  - të njohin dhe të zbatojnë rregullat e përgjithshme të sigurimit teknik dhe pajisjet mbrojtëse personale
3. **Eksperiencia në punë në fushën specifike:**
  - të kenë njohuri praktike për kategoritë për të cilat kërkohet të aplikojë, si dhe së paku një vit përvojë në fushën e zbatimit të kësaj rregulle teknike pranë një kompanie instalimi të linjave elektrike të tensionit të lartë apo një kompanie të ngjashme elektrike;
4. **Aftësitë fizike:** Të jete i afte fizikisht dhe mendërisht për punë, veçanërisht lidhur me të parët, të dëgjuarit, aftësisë lëvizëse, etj. Aplikanti duhet të ketë në dokumentacionin për certifikim, fotokopje e vërtetimit mjekësor i lëshuar jo me vone se 6 muajt e fundit.

### **Instalues i Tipit 2 për linjat ajrore ose nëntokësore me tension të lartë mbi 30 kV.**

Kategoria C.1 - Instalues i Tipit 2 janë personat që bëjnë instalimin e linjave ajrore, ose nëntokësore me tension të lartë mbi 30 kV (përfshirë).

**Aplikantëve dhe mbajtësve të certifikatave të kategorisë “C” Instalues i Tipit 2 i kërkohet:**

1. **Mosha:** Të ketë mbushur moshën 18 vjeç.
2. **Edukimi minimal / Kualifikime / Trajnime:**
  - të kenë kualifikim si teknik i lartë në instalimet elektroteknike, ose arsim inxhinierik të nivelit Bachelor ose Master në këtë fushë.
  - të ketë kryer kurse individuale të njohura nga organi kompetent si ekuivalente me kualifikimet e lartpërmendura, si dhe ekuivalente të tjera të përcaktuara në zbatim të legjislacionit ose marrëveshjeve të tjera ndërkombëtare me vendet e treta, të njohura në Shqipëri;
  - të jetë i pajisur me dëshmi aftësie që dëshmon për punë, pa rrezik, në instalimet elektrike, të tensionit të lartë të lëshuar, nga një organizëm certifikues sipas grupit të III të Sigurimit Teknik.  
të njohin dhe të zbatojnë rregullat e përgjithshme të sigurimit teknik dhe pajisjet mbrojtëse personale
3. **Eksperiencia në punë në fushën specifike:**
  - të kenë njohuri praktike për kategoritë për të cilat kërkohet të aplikojë, si dhe së paku një vit përvojë në fushën e zbatimit të kësaj rregulle teknike pranë një kompanie instalimi të linjave elektrike të tensionit të lartë apo një kompanie të ngjashme elektrike;
4. **Aftësitë fizike:** Të jetë i afte fizikisht dhe mendërisht për punë, veçanërisht lidhur me të parët, të dëgjuarit, aftësisë lëvizëse, etj. Aplikanti duhet të ketë në dokumentacionin për certifikim, fotokopje e vërtetimit mjekësor i lëshuar jo me vone se 6 muajt e fundit.

## KUSHTET PARAPRAKE PËR APLIKIM NË KATEGORIN “D” – Instaluesit e Autorizuar për Instalimet e Tensionit të Lartë mbi 1kV.

### **AT1. Për instalimet elektrike të tensionit të lartë me tension nominal jo më të madh se 30 kV**

Grupi AT1 janë personat që bëjnë instalimet elektrike të tensionit të lartë me tension nominal jo më të madh se 30 kV.

**Aplikantëve dhe mbajtësve të certifikatave të kategorisë “D” grupi AT1 i kërkohet:**

1. **Mosha:** Të ketë mbushur moshën 19 vjeç, duke e dëshmuar me një dokument identifikimi të vlefshëm.
2. **Edukimi minimal / Kualifikime / Trajnime:**
  - të ketë një diplomë universitare në të cilën të përmbahen, përveç të tjerash, edhe lëndët përkatëse, që trajtojnë kompetencën teknike dhe dispozitat rregullatorë, në përputhje me V.K.M. Nr. 483, datë 17.6.2020, ose të ketë një diplomë profesionale në të cilën të përmbahen, përveç të tjerash, edhe lëndët përkatëse që trajtojnë kompetencën teknike dhe dispozitat rregullatorë, në përputhje me V.K.M. Nr. 483, datë 17.6.2020.
  - të jetë i pajisur me dëshmi aftësie që dëshmon për punë, pa rrezik, në instalimet elektrike, të tensionit të lartë të lëshuar, nga një organizëm certifikues sipas grupit të III të Sigurimit Teknik
  - të njohin dhe të zbatojnë rregullat e përgjithshme të sigurimit teknik dhe pajimet mbrojtëse personale.
3. **Eksperiencia në punë:**
  - të kenë njohuri praktike për kategoritë për të cilat kërkohet të aplikojë, si dhe së paku një vit përvojë në fushën e zbatimit të kësaj rregulle teknike pranë një kompanie instalimi të tensionit të lartë apo një kompanie të ngjashme elektrike;
4. **Aftësitë fizike:** Të jetë i aftë fizikisht dhe mendërisht për punë, veçanërisht lidhur me të parët, të dëgjuarit, aftësisë lëvizëse, etj. Aplikanti duhet të ketë në dokumentacionin për certifikim, fotokopje e vërtetimit mjekësor i lëshuar jo më vonë se 6 muajt e fundit

### **AT2. Për instalimet elektrike të tensionit të lartë pa kufij tensioni.**

Grupi AT2 janë personat që bëjnë instalimet elektrike të tensionit të lartë pa kufij tensioni.

**Aplikantëve dhe mbajtësve të certifikatave të kategorisë “D” grupi AT2 i kërkohet:**

1. **Mosha:** Të ketë mbushur moshën 22 vjeç, duke e dëshmuar me një dokument identifikimi të vlefshëm.
2. **Edukimi minimal / Kualifikime / Trajnime:**
  - të ketë një diplomë universitare në të cilën të përmbahen, përveç të tjerash, edhe lëndët përkatëse, që trajtojnë kompetencën teknike dhe dispozitat rregullatorë, në përputhje me V.K.M. Nr. 483, datë 17.6.2020, ose të ketë një diplomë profesionale në të cilën të përmbahen, përveç të tjerash, edhe lëndët përkatëse që trajtojnë kompetencën teknike dhe dispozitat rregullatorë, në përputhje me V.K.M. Nr. 483, datë 17.6.2020.
  - të jetë i pajisur me dëshmi aftësie që dëshmon për punë, pa rrezik, në instalimet elektrike, të tensionit të lartë të lëshuar, nga një organizëm certifikues sipas grupit të IV të Sigurimit Teknik
  - të njohin dhe të zbatojnë rregullat e përgjithshme të sigurimit teknik dhe pajimet mbrojtëse personale.
3. **Eksperiencia në punë:**
  - të kenë njohuri praktike për kategoritë për të cilat kërkohet të aplikojë, si dhe së paku një vit përvojë në fushën e zbatimit të kësaj rregulle teknike pranë një kompanie instalimi të tensionit të lartë apo një kompanie të ngjashme elektrike;
4. **Aftësitë fizike:** Të jetë i aftë fizikisht dhe mendërisht për punë, veçanërisht lidhur me të parët, të dëgjuarit, aftësisë lëvizëse, etj. Aplikanti duhet të ketë në dokumentacionin për certifikim, fotokopje e vërtetimit mjekësor i lëshuar jo më vonë se 6 muajt e fundit.

**Shënim:** Kandidati duhet të zotëroj gjuhën shqipe në të shkruar dhe të folur. Në rastet kur kandidati është i huaj, organi certifikues mund të sigurojë përkthimin, nëse do ketë kosto shtese do përballohet nga kandidati.